



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.74/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Sali Saliu, në cilësinë e kryetarit të Iniciativës politike Partia Tradicionale Shqiptare (PTSH), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. 480/2013 të datës 26.07.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 31.07.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i Sali Saliut, në cilësinë e kryetarit të iniciativës politike Partia Tradicionale Shqiptare (PTSH)

## A r s y e t i m

Me datë 29.07.2013, PZAP-i ka pranuar një apel nga Sali Saliu, në cilësinë e kryetarit të iniciativës politike PTSH, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 480/2013, të datës 26.07.2013, për shkak të mos regjistrimit të iniciativës politike PTSH në regjistrin e partive politike. Parashtruesi i apelit në këtë rast thekson se KQZ ka bërë cenimin e kushtetutshmërisë, aplikimin e gabuar të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), si dhe shkeljen e rregullave procedurale gjegjësisht Rregullën Zgjedhore të KQZ-së 01/2013.

Me këtë rast parashtruesi i apelit kërkon që të anulohet vendimi i KQZ-së dhe të miratohet kërkesa e iniciativës politike PTSH për regjistrim, në regjistrin e partive politike dhe të detyrohet Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), të regjistroi iniciativën politike PTSH sipas kërkesës së parashtruar.

PZAP me datën 30.07.2013, me shkresën me nr. 74/2/2013, kërkoi nga KQZ-ja të gjitha shkresat e lëndës që i kanë paraprirë marrjes së vendimit të ankimuar.

PZAP-i, pranoi nga KQZ-ja, shkresën me nr. protokoli 70/2013 të bashkangjitur me materialin e kërkuar, vërejtjet, dhe sugjerimet e ZRPPC-së, drejtuar PTSH-së, rekomandimin drejtuar KQZ – së, lidhur me iniciativën politike PTSH.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli është i **pa bazuar**:

Nga shkresa nr. 61/2013 datës 05.07.2013, vërtetohet se ZRPPC i ka bërë këto vërejtje dhe sugjerime iniciativës politike PTSH:

Për aktin e themelimit të iniciativës politike, për programin e iniciativës politike, për raportin financiar të iniciativës politike, për statutin e iniciativës politike, për simbolin e iniciativës politike. Iniciativa politike PTSH ka pas afat qe brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit për marrjen e shkresës nga ZRPPC-ja, të plotësoj apo ndryshoj statutin, programin dhe simbolin.

Nga rekomandimi i ZRPPC-së drejtuar KQZ-së vërtetohet se Iniciativa Politike PTSH, brenda periudhës së caktuar nga ZRPPC-ja me shkresën 61/2013 e datës 05.07.2013 nuk i ka sjell ndryshimet e statutit dhe programit por e ka sjell vetëm simbolin e ndryshuar.

Po ashtu edhe nga vendimi i KQZ-së me nr.480/2013 i datës 26.07.2013 vërtetohet se Iniciativa politike PTSH nuk i ka përmbushur vërejtjet dhe sugjerimet nga ZRPPC, të cilat vërejtje dhe sugjerime kanë në harmoni me legjislacionin zgjedhor.

Pas administrimit të të gjitha shkresave PZAP-i konstatoi se iniciativa politike PTSH nuk i ka përmbushur vërejtjet dhe sugjerimet e ZRPPC-së të cilat vërejtje kanë qenë të bazuar në Rregullën nr.1/2013, *Për regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike*. Programi dhe Statuti i iniciativës politike PTSH, siç ka vlerësuar KQZ-ja është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjet në fuqi dhe Rregullën Zgjedhore nr.1/2013.

Sepse edhe vetë parashtruesi i ankesës thekson se programi i kësaj initiative politike është i krijuar mbështetur në katër shtylla, katër ligje dhe kushtetuta paraprake si: Kodin e Justinianit, Kanuni e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Kanunin e Lek Dukagjinit dhe ne Ligjin dhe Kushtetutën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Ndërsa pretendimi ankimor se është dashtë të vendos Zyra e jo KQZ-ja, nuk qëndron sepse sipas nenit 4.1 të Rregullës Zgjedhore nr.1/2013, ZRPPC-ja vetëm i rekomandon KQZ-së lidhur më çështjet ndërsa KQZ-ja, është organ i autorizuar me ligj të vendos lidhur me regjistrimin apo mos regjistrimin e subjekteve politike siç edhe ka ndodhur me rastin konkret, kur KQZ-ja në mbledhjen me nr.38 te datës 26.07.2013, ka vendosur për refuzimin e regjistrimit te iniciativës politike PTSH

Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu duke u bazuar në Rregullën Zgjedhore nr.1/2013, si dhe ne nenin 118.1 të LZP-së dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 74/2013 më datën 31.07.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



#### **Udhëzim Juridik:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*